

Nr. Prot.068/B/18**VENDIMI Nr. 1282****Për****Definim të Tregut****‘Qasja me shumicë bashkë-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikime Elektronike, neni 1, neni 10 paragrafi 5) neni 31, paragrafi 1) paragrafi 3.3) dhe paragrafi 4.1) dhe neni 79 paragrafi 1) dhe 2) (*tutje referuar si; Ligji*); Rregullores Nr. 27 për Analizat e Tregut, (*Ref. ARKEP Nr. Prot. 039/B/14*), neni 3, paragrafët 1), 3) dhe 4), neni 4, paragrafi 3.13) (*tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut*), Rregulloren për Sigurimin e Qasjes, Nr.Prot.012/B/11 (*tutje referuar si - Rregullorja e Qasjes*); Rregullorja për Interkoneksion, Nr.Prot.033/B/11; Rregulloren për Bashkë-shfrytëzimin e plotë dhe të përbashkët të lakut dhe nën-lakut lokal Nr. Prot. 024/B/11 (*tutje referuar si - Rregullorja për LLU*); Direktivës 2002/21/EC të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 7 Mars 2002 për Rrjetat dhe Shërbimet e Komunikimeve Elektronike (Direktiva Kornizë), Rekomandimit të Komisionit Evropian (2003/311/EC), e ndryshuar me Direktivën 2009/140/EC, së bashku me rekomandimin (2007/879/EC) e pasuar me atë të datës; 17 Dhjetor 2007 mbi produktet dhe shërbimet relevante të tregjeve të ndjeshme me rregullimin *ex-ante*; Udhërrëfyesin e Komisionit Evropian mbi analizën e tregjeve dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg sipas kornizës rregullatore për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike (2002/C 165/03); Vendimit Nr. 950 për Analizën e tregjeve të Analiza e Tregjeve të Qasje me shumice brezgjërë dhe Qasja me shumicë bashk-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike’ dhe Përcaktimi i Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg’ të datës; 15 Mars 2017, Nr. Prot. 017/B/17, Vendimet: Nr. 1033 Nr. Prot. 050/B/17,1061 Nr. Prot. 061/B/17 dhe 1168 Nr. Prot. 013/B/18; Raportit mbi Analizën e Tregut të Analiza e Tregjeve të Qasje me shumice brezgjërë dhe Qasja me shumicë bashk-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike’ dhe Përcaktimi i Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg’ (*tutje referuar si - Raporti*); në përputhje me dispozitat e neni 13 paragrafi 1 dhe 5 i Statutit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP), Bordi i ARKEP i përbërë nga,

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar i Bordit
- 2) z. Nijazi Ademja Anëtar i Bordit
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar i Bordit
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar i Bordit
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar i Bordit

në mbledhjen e 33 të Bordit të mbajtur më datë 10 Dhjetor 2018, bazuar në shqyrtimin e materialeve dhe Raportit për analizat e tregut, i përgatitur nga Departamenti për Komunikime Elektronike, vendosi si më poshtë,

V E N D I M

- I. Tregu i **'Qasja me shumicë bashkë-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike'** është definuar për ndërmarrjen **"Telekomi i Kosovës" Sh. A.**
- II. Ky vendim është përfundimtar dhe hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Në bazë të nenit 10 paragrafi 5) i Ligjit përcaktohe se Autoriteti *"Miraton vendimet në lidhje me përcaktimin e tregjeve përkatëse, kryen analizat e tregut dhe imponimin, si dhe tërheqjen e obligimeve të rregullatorit tek operatorët me fuqi të ndjeshme tregu"*.

Neni 31 paragrafi 1 i Ligjit përcakton se Analiza duhet të bëhet nga Autoriteti, kurse paragrafi 3.3) i këtij neni përcakton se Autoriteti ka të drejtë të bëjë një Analizë të tregut me vetiniciativë.

Neni 31 paragrafi 4) përcakton fazat e analizës së tregut, ku faza e parë është *"përcaktimi i tregut relevant (produkti/shërbimi dhe shtrirja gjeografike), karakteristikat e të cilit mund të jenë të tilla për të justifikuar imponimin e detyrimeve referuar në nenin 32 të këtij Ligji.*

Gjatë procesit të Analizës së Tregut për **'Qasja me shumicë bashkë-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike'** (tani e tutje i referohemi si - LLU) pyetësorët u janë dërguar të gjitha ndërmarrjeve relevante të Autorizuara për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

Sqarimet esenciale të ndërmarrjeve të pyetura janë paraqitur dhe vlerësuar në Raportin **'Analiza e Tregjeve të Qasje me shumice brezgjerë dhe Qasja me shumicë bashkë-shfrytëzim - LLU (duke përfshirë qasjen e ndarë) në laqet metalike dhe nën-laqet me qëllim ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike'** dhe **Përcaktimi i Operatorit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (OFNT)'**.

Siç është cekur në Kapitullin V të Raportit:

- Tregu i LLU përbënë një treg të veçantë dhe është definuar me mbulueshmëri në tërë territorin e Republikës së Kosovës (treg kombëtar) dhe përfshinë çiftoret e përdredhura metalike të laqeve lokale siç është definuar në nenin 2 të Rregullores për **'Analizat e tregut.**

Siç është cekur në Raport në Kapitullit V:

- "Telekomi i Kosovës" Sh.A. ka pjesëmarrje prej 100% në treg sa i përket LLU.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit.

Prishtinë, 26/12/2018

Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve të Autorizuar të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës;
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik
- Arkivit të ARKEP-it